

The Ergotherapist



Përmbajtja

1. Perspektivë
2. Puna e shëndetit mendor
3. "Help for Heros"
4. Etika në praktikën profesionale
5. Pamja e Karaibeve Veriore
6. Qeni i shërbimit
7. Konferencat
8. INKET

Perspektivë...

Një ergoterapeute në zhvillim, që përveç gjitha profesioneve të cilat ka dëshirë të i eksperimentoj, artin e ka një fushë të pandashme emocionale.



Odë e Jetës, sheshi Zahir Pajaziti, Prishtinë, (HAPU Fest 2019)

Fotografi: Amir Vitija

Muajin që lam pas në qytetin e Prishtinës dhe Fushë Kosovës (Kosovë), u zhvillua edicioni I pestë I Festivalit të Artit në Hapësirë Publike-HAPU. Festival të cilin vitet e para e ndjekja vetëm përmes rrjeteve sociale, pastaj si publik, vitin e kaluar u bashkova si vullnetare, e entuziazmuar për zhvillimin e një festivali të natyrës së tillë, dhe përfundimisht këtë vit pjesë e stafit organizativ dhe në menaxhim të komunikimit me publik. Duket që për gjërat që duam provojmë të gjejmë hapësirë çdo herë.

Koncepti I festivalit dhe arsyeja pse e dua?

Hapësirat e super frekuentuara dhe rrugët e mononotshme të një qyteti mesatar, çdo herë duke kaluar me vrap në nguti e sipër për punën, shkollën, provimin ose për të takuar miqtë, dhe në qoftëse jo njëra nga ato atëherë e lodhur nga dita, plotësisht e pavëmendshme për hapësirën përreth e përhumbur në kalkulimet se sa kohë kam deri sa të arrijë në shtëpi, duke aranzhuar në mendje kohen e ushqimit, përfundimit të detyrave/raporteve ditore për praktiken profesionale, sa kohë do mund t'a shijoj mbrëmjen për të lexuar ose përdorur mobilin, pastaj edhe orët se sa do të arrijë të fle. Për të vazhduar me të njejtën rutinë të nesërmen. Duke lejuar kështu të rrëmbëhem në valen e angazhimit dhe të humb ndjesinë e këndshme për vendet që më rrethojnë dhe I shfrytëzoj të pakten një herë në ditë, secilen ditë.

Pikërisht në këtë valë angazhimi, në qytet ofrohet art kontaporan, premiera dhe performanca që prekin direkt ndjenjat dhe ajo ofrohet në ato hapësira të zakonshme të qytetit të cilat janë të mbi ngarkuara dhe unë ngutem çdo ditë t'i kaloj sa më shpejtë që t'u shmangem turmave dhe zhurmave monotone, dhe ofrohet falas. Të përjetosh në këto hapësira, sekuenca arti si p.sh projeksion tingullor që buron nga koncepti I artistit mbi zhvillimin e jetës së fetusit dhe fazat e njohjes së zërit, ndikimin e së jashtmes ("Odë e Jetës"- nga Donika Rudi) ose një performancë ndërdisiplinare ku ndërthuren vallëzimi, arti dhe muzika me anë të lojës së dy valltarëve që ndërhyjnë në tempon e kalimtarëve (Tape Riot- nga Asphalt Piloten), është një sprovë që arrin të luhas mënyrën se si I shohim hapësirat, gjërat dhe perspektiven tonë mbi përditshmërinë, njerzit dhe vet trupat tanë dhe aftësinë e tyre për të zhvilluar lojë përhumbëse.



Tape Riot, Fushë Kosovë, (HAPU Fest 2019)

Fotografi: Amir Vitija



The snowball effect, sheshi Adem Jashari, Prishtinë (HAPU Fest 2019)

Fotografi: Rahman Osmani

Është gjithmonë një ndjesi interesante dhe e këndshme të shkëputesh për pak momente për në botën plotë ngjyrëshe të artit kontaporan, dhe pastaj të zhvillosh një koncept të ri të menduarit ose një perspektivë të re reflektimi ndaj përditshmërisë, por mbi të gjitha të shijosh një javë feste të artit dhe shoqërimit.

Diana Markaj
Ergoterapeute

Puna e shëndetit mendor

Mary Burgess diplomoi dhe fitoi licencën në vitin 2017; ajo punoi në mjediset e shëndetit mendor në komunitet me të rriturit, përpara se të merrte rolin e saj të tanishëm këtë vit në një spital të sigurt ligjor (forenzik).

Cili është roli juaj aktual?

Roli im aktual si ergoterapeute është brenda një spitali të sigurt ligjor. Unë punoj në një "qendër" që përbëhet nga tre reparte, dy nga tre janë aktualisht të hapura dhe mbajnë deri në dymbëdhjetë pacientë secila. Zyra ime është e vendosur në katin e sipërm, që ndihmon në sigurimin e një qasjeje ekipore, deri te puna në bashkëpunim. Unë lehtësoj grupet e ndryshme që synojnë të ofrojnë aktivitete kuptimplote për pacientët dhe kanë qëllimin e dyfishtë të ofrimit të mundësive për vlerësimin funksional dhe zhvillimin e aftësive. Unë gjithashtu punoj me pacientët një-me-një, duke përdorur një varg të vlerësimeve MOHO (modelet e angazhimeve të njeriut).



Jam gati për të përfunduar kursin e Vlerësimit të aftësive motorike dhe procesive (AMPS) gjatë muajit të ardhshëm. Ky kualifikim do të jetë mjaft i dobishëm për mua, pasi do të mundësojë standardizmin dhe vlerësimin gjerësisht të njohur të aftësive motorike dhe të procesit dhe të sigurojë një matje bazike të funksionimit të pacientit.

Përshkruani një ditë të zakonshme ...

Një ditë tipike përfshin të kujdesem në repart kur të arrij të marr një dorëzim nga stafi infermierik në lidhje me paraqitjen e tanishme të pacientëve. Pas kësaj, caktoj prioritetet se çfarë duhet të bëj për ditën e ardhshme, kjo zakonisht është e dizajnuar për t'u përshtatur në takimet e ndryshme të cilat i ndjek. Këto shkojnë nga takimet e CPD, OTteam mbledhjet, takimet e praktikave të reflektimit, takimet e forumeve klinike dhe takimet e Qasjes së Programit të Kujdesit (CPA), për të përmendur vetëm disa.

Për shkak të natyrës së grupit të pacientëve, planet shpesh ndryshojnë me njoftim të shkurtër, gjë që mund të thotë kërkohet të përshtatem shpejt dhe të jam kreative me metodat e ndërhyrjes. Ekipi i punës multi-disiplinore është një komponent thelbësor i punës time të përditshme. Më pëlqen ky aspekt pasi fuqizon marrëdhëniet e ekipit dhe me rëndësi, përfitojnë pacientët. Marrja e kohës për të reflektuar mbi ditën është me rëndësi jetike, më lejon të marr parasysh fushat për zhvillimin personal dhe profesional. Ndjehem i privilegjuar që reflektimi është i njohur gjerësisht në vendin tim të punës si një fushë e vlefshme e praktikës.

Cila është pjesa më e vështirë e punës tuaj?

Pjesa më e vështirë e punës sime priret të përqëndrohet rreth nevojës për të qenëtejet kreative në mënyrë që të lehtësojë sesionet e terapisë. Për shkak të nivelit të lartë të sigurisë, çfarë do të dukej si një detyrë e përditshme në klinikat të tjera, mund të bëhet mjaft sfiduese. Vlerësimi i rreptë i rrezikut është prioritet dhe përshtatja e praktikës për të përballuar këto nevoja mund të jetë e vështirë. Ne nuk kemi qasje ndaj mjeteve të mprehta, përfshirë thikat e kuzhinës dhe kujdes maksimal, kurse masa të kontrollit mirren për të punuar me kanaqe dhe xham. Që kur punoj në rolin tim aktual, akoma jam duke e zotëruar artin e prerjes së një qepe me thikë pa maje.



Cila është pjesa më e mirë e punës tuaj?

Pa dyshim, pjesa më e mirë e punës sime është të punosh në një mjedis në të cilin vlera e dhënë ergoterapisë është aq e lartë, sidomos nga pacientët në spital. Për popullatën e pacientëve tanë, shpesh motivimi dhe vullneti janë sfida të forta, megjithatë, shumë nga ata janë entuziastë dhe të prirur për të marrë pjesë në sesionet e ergoterapisë. Aftësia për të siguruar një aktivitet kuptimplotë i cili u mundëson ndjenjën e vetvetës, fuqizimit dhe pjesëmarrjes, siguron kënaqësi të vazhdueshme pune.

Përktheu: m. Teuta Augustini



“Help for Heroes”

Alexandra Lovett kohët e fundit ka marrë postin e ergoterapeutit me ndihmën e bamirësisë në Help for Heroes (Ndihma për heronjtë). Bazuar në Qendrën e Rimëkëmbjes Tedworth House, Alexandra ndan atë që përfshin roli i saj me personelin e shërbimit ndaj të plagosurve.

Qe tetë muaj unë jam ergoterapeute tek Help for Heroes e bazuar në bamirësinë e Tedworth House Recovery Centre në Tidworth, Wiltshire. Pasiqë jam ende relativisht e re në këtë rol, po mësoj gjithë kohën. Nga sfondi i punës në neurologji, unë tani jam duke punuar kryesisht me njerëz që kërkojnë mbështetje të shëndetit mendor. Kjo prapavi në neurologji ka qenë e dobishme, pasi që disa veteranë kanë nevoja njohëse së bashku me çështje të tjera. Kjo më ka lejuar që të adresoj vështirësitë e performancës së angazhimit nga disa kënde të ndryshme dhe të bëj kalimin ndërmjet qasjeve të cilat i kam zbuluar si jetësore në këtë rol.



Help for Heroes ka qenë një bamirësi për 11 vite. Duke u nisur nga ideja e dy njerëzve të cilët e ndjenë nevojën të "bëjnë diçka" dhe nga një fillim i përvuajtur në një kasolle llamarine, në vetëm 11 vite, tani është bërë një bamirësi nacionale që ka mbështetur mbi 21,000 të plagosur, të lënduar, personel të shërbimit të të sëmurëve, veteranë dhe familje të tyre. Është për çdo njeri, shëndeti ose mirëqenia e të cilit është prekur nga shërbimi në forcat e armatosura ose të ndonjë forme të armatosur dhe synon t'i mbështesë ata për jetë.

Help for Heroes ofron një gamë të mbështetjes duke përfshirë mbarëvajtjen, shëndetin dhe mirëqenien, sportin dhe kohën e lirë, drejtimin e karrierës dhe mbështetjen klinike, përfshirë këtu ergoterapinë.



Unë zgjodha Modelin e angazhimeve të njeriut (MOHO) të Kielhofner-it për të mbështetur veteranët ushtarakë me vështirësitë e tyre funksionale, ndërkohë që ndjeva se ishte model me klientin në qendër dhe do të më lejonte të përqendrohesha në fusha të përbashkëta të vështirësive siç janë motivimi dhe ndryshimi i roleve që ndodh gjatë largimit nga ushtria për shkaqe mjekësore. Roli im është i dyfishtë, që të t'u mundësoj qasje në shërbime të tjera të ofruara nga Help for Heroes dhe për të përmirësuar



cilësinë e jetës së atyre njerëzve që më janë referuar për ndihmë. Nuk ka një veteran mesatar dhe është një rol emocionues, sfidues dhe unik, të cilin e pëlqej shumë. Në kohën kur Help for Heroes filloi, pas luftërave të Irakut dhe Afganistanit, ishte më e zakonshme që individët të ktheheshin nga konflikti me lëndime fizike, megjithatë, kjo ka ndryshuar tani. Kushtet e shëndetit mendor tek veteranët po bëhen gjithnjë e më të përhapura dhe efekti që kanë në aftësinë e veteranëve për të jetuar jetën që ata duan ta udhëheqin është i rëndësishëm.

Si ergoterapeut mund të shikoj personin në mënyrë holistike dhe të marr parasysh të gjitha forcat, vështirësitë dhe mjedisin në të cilin ndodhin këto dhe t'i sjelli para ekipit. Kultura ushtarake është unike dhe kam mësuar shumë për të nga perspektivat e veteranëve. Për shumicën, ushtria ka qenë familja e tyre, ndonjëherë për shumë vite. Lënia e asaj jete mund të krijojë një tronditje kulturore, të cilën veteranët përpigën ta menaxhojnë, e cila pastaj mund të krijojë ndonjë vështirësi fizike apo mendore, sidomos në një shkarkim mjekësor kur nuk ishte zgjedhja e tyre. Ergoterapia në Help for Heroes do të shikojë çdo nevojë që lind përmes vlerësimit duke përfshirë aty ndihmën rreth veshjes, teknologjisë adaptive për të mbështetur humbjen e kujtesës dhe aktivitetet e kohës së lirë, megjithatë, vëllimi më i madh i referimeve është për nevojat e gjumit. Megjithatë gjumi është një funksion i përditshëm i domosdoshëm, nuk trajtohet shpesh në mjediset tradicionale të ergoterapisë. Tedworth House Recovery Centre ka avantazhin e dhomës shqisore me resurse të mira që përdoret së bashku me vlerësimet ndijore, këshillat e higjienës së gjumit dhe edukimin mbi ndikimin e kushteve shëndetësore në gjumin për të provuar modele më të shëndetshme të gjumit dhe për t'u dhënë veteranëve mjete për të menaxhuar vështirësitë e tyre unike të fjetjes. Kjo kërkon shumë zgjidhje kreative të problemeve.

Help for Heroes është ende relativisht e hershme në krijimin e shërbimit të ergoterapisë që filloi vetëm në vitin 2014 dhe tani është koha e drejtë të shqyrtohet si të zhvillohet shërbimi për të ardhmen. Gjithmonë kërkoj të krijoj lidhje me shërbime të tjera që ofrojnë mbështetje për veteranët, sepse besoj se puna e përbashkët është mënyra më efektive për të ndihmuar veteranët tanë.



Alexandra.lovett@helpforheroes.org.uk

Përktheu: m. Teuta Augustini

Lëndimet në Duar

<https://www.theotpractice.co.uk/news/our-experts-blog/a-professionals-guide-to-hand-therapy>



MESSAGE FROM THE CHAIR

The Scientific Committee welcomes all of you to Nice, France for the 58th Annual Scientific Conference. In addition to enjoying the beauties of the Cote d'Azur and French Riviera, we are excited to offer a meeting filled with the latest advancements in the treatment and rehabilitation of individuals with spinal cord injuries and disorders. Dr. Claes Hultling will provide the honored Guttmann Lecture, and will be joined by several other notable plenary speakers addressing topics of autonomic functioning, musculoskeletal complications, sexuality and fertility, and neural repair through molecular and therapeutic translation. Your attendance at the meeting will enrich your scientific and clinical knowledge and offer an outstanding opportunity to network with colleagues from around the globe.

We look forward to seeing you in Nice!



Dr G Scivoletto
Chair, ISCoS Scientific Committee

Etika në praktikën profesionale

Ethics in Professional Practice: An Education Resource for Health Science Students

Belinda Kenny

The University of Sydney, Australia

Kate Thomson

The University of Sydney, Australia

Amanda Semaan

The University of Sydney, Australia

Laura Di Michele

The University of Sydney, Australia

Natalie Pollard

Queensland University of Technology, Australia

Madelyn Nicole

The University of Sydney, Australia

Yobelli Jimenez

The University of Sydney, Australia

Lindy McAllister

The University of Sydney, Australia

Abstract

Ethical practice is a core health science graduate attribute yet ethical reasoning is rarely explicitly taught during professional placements. Our aim was to design an educational resource for health science students to 1) engage students in the topic of ethics and 2) facilitate their skills to identify, manage and communicate ethical issues during professional placements. The Ethics in Professional Practice (EPP) resource was developed using collaborative design-based research by an interprofessional, Work Integrated Learning team. We drew upon Barab and Squire's (2004) approach, with cycles of design, analysis, redesign and feedback informing resource development. The EPP resource comprises five video case studies that reflect ethical issues from diverse professional practice environments and include perspectives from students, clinical educators, clients and caregivers. The student is cast as a central character who must decide what actions may be taken to resolve ethical conflict.

Complementary ethics education resources include reflective questions, guides to ethical reasoning and goal-setting resources. The resource was implemented with a cohort of 15 graduate-entry exercise physiology students and 59 undergraduate speech pathology students from the University of Sydney. Student feedback was utilised to inform resource redesign. Findings indicated that students valued the authentic ethics scenarios but experienced challenges when navigating online learning activities. Redesign focussed on enhancing interactive design features and improving accessibility of learning activities. This project achieved our goals to address ethical sensitivity, reasoning, communication and goals for future ethical practice.

International Journal of Practice-based Learning in Health and Social Care
Vol. 7 No 1 July 2019, pages 86-101

Download article from:

<https://publications.coventry.ac.uk/index.php/pblh/issue/current>

Pamja e Karaibeve Veriore

Të nderuar lexues,

Unë jam Shennell Challenor, ergoterapeute (OT) prej 10 vjetësh. Duke u rritur në ishullin Barbados, kam dashur gjithmonë të punoja me fëmijë. Në moshë të re fillova të hartoja udhëtimin tim për të ndjekur ëndrrën time.

Kjo u bë realitet kur shkova në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2003 për të vazhduar më tej studimet dhe për të ndjekur një karrierë në pasionin tim, pediatri.

Pasi u diplomova fillova në një shkollë të vogël

fillore dhe të mesme të pavarur, të themeluar nga prindërit për fëmijët me Autizëm, duke punuar në të dy anët. Ndërsa një sfidë, si e pazakontë për të hyrë drejt e në pediatri (një zonë e specializuar) drejt prej universitetit. E pashë këtë si një privilegj dhe fillim i mirë të arrija përvojën që më duhej për t'u bërë OT më e mirë që mund të isha.

Vendosja tjetër ishte në NHS (National Health Service), duke punuar me fëmijë nën pesë vjeç, gjë që ishte e panjohur për mua. Një tjetër kthesë e të mësuarit, megjithatë jo e krahasueshme me punën time të parë. Kam punuar në shkollë, si dhe në një klinikë zhvillimore. Kjo zgjeroi njohuritë dhe përvojën time me voglushat nën 5, dhe ndërtoi besimin tim si ergoterapeute. Unë me të vërtetë e vlerësova mundësinë për të punuar aty si dhe që isha pjesë e një ekipi të madh OT dhe një ekipi më të gjërë shumëdisiplinor.

Dy vjet më vonë, një vend i ri OT, drejtoja një kompani të vogël. Fillimisht kam përdorur një agjenci për të gjetur punë dhe e gjeta veten duke

punuar në një bashki tjetër në një ekip të vogël të komunitetit pediatrik. Gjatë 4 viteve e gjysëm

aftësitë e mia u testuan përfundimisht, përkundër kohës. Kishte afate të rrepta për të zvogëluar një rritje gjithnjë e më të madhe të listave të pritjes. Kam ofruar një shërbim premium, duke ruajtur një nivel të lartë profesionalizmi dhe shërbimi ndaj klientit. Më është dashur të përdori aftësi të mira vëzhguese dhe gjykim klinik, duke i dhënë përparësi punës së mirë në ekip dhe komunikimit me stafin e administratës.



Bota e praktikës private mund të ketë të përparësitë dhe të metat e veta. Unë i kam provuar të dyja, por isha e kënaqur që rolet e mia të mëparshme më kishin përgatitur. Isha e lumtur që kisha disa trajnime në Integrimin Sensorik dhe kjo

ishte specialiteti i saj. Kishte shumë kohë për punë të vetme. Ky vend praktike sfidoi kursimin e kohës sime dhe komunikimin. Në fillim nuk e dija se punët e ardhshme që do të kisha, do të ishin relativisht afatshkurtër dhe me shumë aspekte, por që në fundit me të vërtetë më kënaqën.

Disa muaj më vonë u ktheva në atë Shkollën e pavarur si më e pjekur dhe ergoterapeute me përvojë. Kam shërbyer 3 vjet e gjysëm atje. Në të njejtën kohë kam punuar edhe në disa shkolla fillore integruese.

Tani jetoj me burrin tim në një ishull tjetër në Karaibet Veriore. Si përfundova këtu është një histori tjetër, që do t'ju zbuloj në edicionin tjetër. Qëndroni në rrjedha.



Kontakti: S.challenor@jumpaheadot.co.uk

[@ShennellChallenor](https://www.instagram.com/ShennellChallenor)


Përktheu: *M. Teuta Augustini*

25th ENOTHE Annual Meeting 2019

The 25th ENOTHE Annual Meeting will take place on 17 – 19 October 2019, hosted by the Department of Occupational Therapy, Metropolitan College, Athens, Greece.



The Metropolitan College, BSc (Hons) Occupational Therapy, in collaboration with Queen Margaret University in Scotland is the first university programme in Occupational Therapy offered in Greece and is approved by the World Federation of Occupational Therapists (WFOT).





A1 Block, Calabria, Pristina

+386(0)49 556 000

info@europrinty.net/sales@europrinty.net

Europrinty Ltd. është një grup i kompanive që kanë qenë gjithmonë të orientuara drejt punës në një mënyrë të përqendruar, duke pasur të drejta ekskluzive të shitjes nga prodhuesit e njohur për produktet për zyra dhe ato shkollore, furnizimet dhe pajisjet e IT-së dhe industrinë e shtypit.

Gama e produkteve po zgjerohet çdo ditë dhe në vitet e fundit kemi përfshirë linjë të ndryshme të shpërndarjes për loda edukative, veshje dhe pajisje për udhëtime.

Ofron 3% zbritje

të prodhimeve për

Institutin Kosovar të Ergoterapisë

shop-europrinty.com

TWIN computers

Prishtina

Isa Boletini Nr. 174, Prishtinë

Tel +386 49 826 111 / +381 38 728 051

E-mail shpendselimaj@gmail.com

15% zbritje për

Instituti Kosovar të Ergoterapisë



Instituti

Kosovar i

Ergoterapisë

NGO 5117184-5

Emri: Name

Numri: 000000000000



**KARTË E
ZBRITJES**

Free Downloadable Therapy Tools / Mjete Falas për Terapinë e Shkarkueshme

<https://theinspiredtreehouse.com/wp-content/uploads/2019/07/ultimate-therapy-bundle-info-printables.html>

The logo for the Occupational Therapy Show features a large, stylized 'OT' in black and teal. The 'O' is a solid black circle, and the 'T' is a teal shape with a circular cutout at the top left.

Occupational Therapy Show


27th and 28th Nov 2019 NEC Birmingham
www.theotshow.com

Welcoming Royal College of
Occupational
Therapists



The Occupational Therapy Show attract's over 5,000+ OT professionals from across the UK – It is FREE!

Last year saw thousands of OT professionals gathering at The Occupational Therapy Show, making it the UK's largest free to attend education and trade event for the OT industry. Visitors gave the free-to-attend, two day CPD accredited education conference and exhibition a resounding thumbs up – as did the hundreds of exhibitors including the trade's biggest brand names. We can't wait to welcome more OT's this year at The 2019 OT Show on the 27th and 28th November.





<https://healtheconomics.healthconferences.org/>



<https://physiotherapy-sportsmed.inovineconferences.com/>



<https://www.med.uio.no/helsam/english/research/groups/charm/events/bnc2019.html>

INSTITUTI KOSOVAR I ERGOTERAPISË



Kemi nevojë për Vullnetarë
Dëshironi të ndihmoni me aktivitete të tilla si ngjarje të promovimit në qendrat tregtare, shkolla, etj?



Ju lutemi të kontaktoni:
Rina Hajdaraga ose Drenusha Rogova,
për më shumë informacion.
Ju mirëpresim të gjithë!



Bashkohu me ne në Facebook



rinahajdaraga@live.com
drenusharogova@icloud.com



+386 49 642 849



www.kosovoergotherapists.com

Semitronix HOTEL

As soon as you arrive you will receive a warm welcome from our attentive and lovely team, who will be more than happy to help you choose the right room

Our rooms are designed to accommodate your every need and the room service is at your disposal 24 hours a day so you can treat yourself to breakfast in bed or a lunch in your private spacious balcony.



Hotel Rooms



Restaurant



Conference rooms

Wellness

RELAX AND RESTORE YOUR ENERGIES



Your journey to total relaxation and well-being begins on the 9th floor of our hotel, where a spectacular and unique rooftop sanctuary comprises a breathtaking pool, massage room, sauna and fitness room.

**Str. Lidhja e Pejës
Pristina, Kosovo
Tel: +383 (0) 38 740 222**

E RËNDËSISHME

Nëqoftëse e njihni dikë që dëshiron të marrë një kopje të The Ergotherapist, ju lutem më dërgoni detajet e më poshtme.

Kjo është mënyra që ju të tregoni se çfarë mund të arrijë PROFESIONI JUAJ.


Emri i personit:

Email adresa:

Profesioni:

Vendi i punës:

Falënderojmë të gjithë ata që na kanë dërguar detajet kontaktuese muajin e kaluar!



Stuart's
Thought!

**You can discover more about a person in an hour of play
than in a year of conversation!**